

Ahmet Imami, MA¹

UDC:
347.962-044.325(497.115)

**SFIDAT E REFORMIMIT TË SISTEMIT GJYQËSOR NË
REPUBLIKËN E KOSOVËS**

**ПРЕДИЗВИЦИТЕ И РЕФОРМИТЕ НА СУДСКИОТ СИСТЕМ
ВО РЕПУБЛИКА КОСОВО**

**CHALLENGES OF REFORMING THE JUDICIAL AND
PROSECUTOR SYSTEM IN THE REPUBLIC OF KOSOVO**

Abstract

The purpose of this scientific paper is to elaborate on the challenges presented in case of reforms in the judicial and prosecutorial system of the Republic of Kosovo. Reforms in the judicial and prosecutorial system in the Republic of Kosovo were made in 2013, where during the process of these reforms, the judicial and prosecutorial system has faced a number of challenges that have posed obstacles to the implementation of these reforms. The challenges faced during the reform process in the judicial and prosecutorial system of the Republic of Kosovo are: the lack of facilities; the insufficient number of judges and the more active cases of active judges; security of judges and prosecutors; the transfer of judges and prosecutors as well as the seats reserved for the non-majority community in the judicial and prosecutorial system of the Republic of Kosovo. The above mentioned challenges have shown the inability to fully implement the reforms made in 2013, within the justice system of the Republic of Kosovo. With this scientific paper, the author intends to make a better and clearer review to find out exactly what

¹ Autori është asistent në Fakultetin Juridik të Universitetit Publik të Gjilanit “Kadri Zeka” dhe doktorant në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”. E-mail: (ahmet.imami@hotmail.com).

challenges the judicial and prosecutorial system faced during their reform in 2013. We hope that this scientific paper will serve positively for all the scientific workers, professors, judges, prosecutors, lawyers, students, etc.

Key words: Challenges, Judicial and Prosecutorial System, Republic of Kosovo and Reform.

1. Hyrje

Sistemi i drejtësisë në të gjitha shtet demokratike në sistemet bashkëkohore, po ashtu edhe në Republikën e Kosovës ka rëndësi të madhe për funksionalizimin e të gjitha institucioneve shtetërore, si atyre legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore, duke u bazuar në kushtetutën, ligjet dhe të gjitha aktet tjera nënligjore të atij shtetit demokratik.

Deri në janar të vitit 2013, sistemi i drejtësisë në Republikën e Kosovës kishte një strukturë tjetër organizative dhe funksionale, si sistemi gjyqësor ashtu edhe sistemi prokurorial.

Në vitin 2013 janë bërë reformat brenda sistemit të drejtësisë duke u ndryshuar tërësisht struktura organizative dhe funksionale në sistem gjyqësor dhe atij prokurorial.

Gjatë procesit të këtyre reformave është hasur në sfidat që kanë paraqitur vështirësi të mëdha në implementimin e reformave në tërësi. Sfidat të cilat janë paraqitur janë: mungesa e objekteve; numri i pamjaftueshëm i gjyqtarëve dhe ngarkesa më lëndë të gjyqtarëve aktiv; siguria e gjyqtarëve dhe prokurorëve; transferimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe vendet e rezervuara për komunitetin jo shumicë në sistemin gjyqësor dhe atij prokurorial të Republikës së Kosovës.

Pasi që këto sfida kanë paraqitur vështirësi të madhe në implementimin e reformave në fjalë, atëherë kam parë të arsyeshme që të bëjë një punim shkencor lidhur me këto sfidat, me qëllim të gjithë punëtorët shkencorë, e në veçanti profesorët, juristët, gjyqtarët, prokurorët, avokatët, studentët, e shumë të tjerë që të njoftohem në mënyrë të qartë se më çfarë sfida është ballafaquar reformimi i sistemit të drejtësisë në Republikën e Kosovës.

Me qëllim të elaborimit sa më të mirë të këtij punimi do të përdoren metoda të ndryshme të cilat janë: metoda juridike, metoda krahasimore, metoda sociologjike, metoda analitike, metoda e intervistës, si dhe metoda historike juridike.

2. Mungesa e objekteve

Një ndër sfidat kryesore të këtij reformimi të sistemit gjyqësor është mungesa e objekteve adekuate për gjykatat, ku sipas një hulumtimi të bërë, në Kosovë janë 33 objekteve nga të cilat tri (3) objekte janë me qira, ndërsa hapësira e tërë objekteve në Kosovë është 31.500 m², sipërfaqe e cila nuk mjafton për reformën e sistemit gjyqësor.² Sfidat tjera, të cilat kanë vështirësuar reformimin e sistemit gjyqësor në Republikën e Kosovës, kanë qenë:

- Mungesa e sallave të gjykimit;
- Mungesa e zyrave për gjykatës dhe personel tjetër të gjykatës;
- Mungesa e dhomave të veçanta për dëshmitarë të mbrojtur;
- Mungesa e hapësirave për publik;
- Mungesa e hapësirave për qëndrimin e të burgosurve;
- Mungesa e hapësirave në zyrat për menaxhimin e lëndëve; etj.³

Mungesat e lartpërmendura kanë qenë pengesa të shumta për Këshillin Gjyqësor gjatë reformimit të sistemit gjyqësor në Republikën e Kosovës.

Sa i përket në reformat e sistemit prokurorial, në aspektin e objekteve nuk ka pasur ndonjë vështirësi të madhe, të gjitha objektet e prokurorive të strukturës të së kaluarës janë zëvendësuar më strukturën e re të reformimit të sistemit prokurorial në Kosovë.⁴

3. Numri i pamjaftueshëm i gjyqtarëve dhe ngarkesa e tyre me lëndë

Sipas të dhënave statistikore shihet qartë se, në sistemin gjyqësor të Republikës së Kosovës, kemi shumë lëndë të pazgjidhura dhe një ndër arsyt kryesore për mos zgjidhjen e lëndëve është numri i pamjaftueshëm i gjyqtarëve. Mendoj se kjo sfidë e sistemit gjyqësor në Kosovë ka ekzistuar edhe para reformave, gjithashtu po ekziston edhe pas reformave të sistemit gjyqësor në Kosovë. Për shembull, në vitin 2012, do të thotë para reformimit të sistemit gjyqësor, kanë ekzistuar këto statistika: Gjykata Supreme, në vitin 2012, ka gjykuar me gjithsej 13 gjyqtarë, kurse numri i lëndëve të pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese ka qenë 3422 lëndë. U janë shtuar edhe lëndët e reja të pranuar gjatë periudhës raportuese të cilat kanë qenë 4694 lëndë dhe

² Këshilli Gjyqësor i Kosovës, “Intervistë me z. Enver Peci - kryesues i KGJK-së”.

³ Po aty.

⁴ Këshilli Prokurorial i Kosovës, “Intervistë me z. Shkëlzen Maliqi - drejtor i përgjithshëm i KPK-së”.

numri i lëndëve të pazgjidhura ka arritur në 8116 lëndë, kurse gjatë gjithë periudhës raportuese janë zgjidhur vetëm 4666 lëndë, dhe prapë, në fund të periudhës raportuese, kanë mbetur 3450 lëndë të pazgjidhura.

Nëse i veçojmë çështjet administrative në Gjykatën Supreme kemi pasur këto statistika: lëndët e pazgjidhura për çështjet administrative në fillim të periudhës raportuese kanë qenë 1529 lëndë, u janë shtuar edhe lëndët e reja të pranuar gjatë periudhës raportuese të cilat kanë qenë 1759 lëndë, dhe numri i lëndëve të pazgjidhura ka arritur në 3288 lëndë, kurse gjatë periudhës raportuese janë zgjidhur 1522, dhe prapë, në fund të periudhës raportuese, kanë mbetur 1766 lëndë të pazgjidhura.⁵

Ndërsa, në të gjitha Gjykatat e Qarkut në Kosovë, në vitin 2012 kanë gjykuar gjithsej 47 gjyqtarë, kurse numri i lëndëve të pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese ka qenë 10376 lëndë, u janë shtuar edhe lëndët e reja të pranuar gjatë periudhës raportuese të cilat kanë qenë 12552 lëndë dhe numri i lëndëve të pazgjidhura ka arritur në 22982 lëndë, kurse gjatë gjithë periudhës raportuese janë zgjidhur vetëm 12195 lëndë, dhe prapë, në fund të periudhës raportuese, kanë mbetur 10733 lëndë të pazgjidhura.⁶

Sa i përket Gjykatave Komunale të Kosovës, në ato gjykata kanë gjykuar gjithsej 117 gjyqtarë, kurse numri i lëndëve të pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese ka qenë 194470 lëndë, u janë shtuar edhe lëndët e reja të pranuar gjatë periudhës raportuese të cilat kanë qenë 72843 lëndë, dhe numri i lëndëve të pazgjidhura ka arritur në 267313 lëndë, kurse gjatë gjithë periudhës raportuese janë zgjidhur vetëm 75227 lëndë, dhe prapë, në fund të periudhës raportuese, kanë mbetur 192086 lëndë të pazgjidhura.⁷

Pas reformave në sistemin gjyqësor të Kosovës, në vitin 2013, Gjykata Supreme ka këto statistika: Numri i gjyqtarëve është i njëjtë, do të thotë Gjykata Supreme edhe pas reformave prapë ka 13 gjyqtarë për zgjidhjen e lëndëve. Lëndët e pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese kanë qenë 904 lëndë, u janë shtuar edhe lëndët e reja të pranuar gjatë periudhës raportuese të cilat kanë qenë 9701 lëndë dhe numri i lëndëve të pazgjidhura ka arritur në 10605 lëndë, kurse gjatë gjithë periudhës raportuese janë zgjidhur 10491 lëndë, dhe prapë, në fund të periudhës raportuese, kanë mbetur 114 lëndë të pazgjidhura.

⁵ Këshilli Gjyqësor i Kosovës, “Departamenti i Statistikës”, raporti vjetor 2012, f. 4.

⁶ Po aty, f. 9.

⁷ Po aty, f. 18.

Pas reformave të sistemit gjyqësor në Kosovë, Gjykata Supreme ka rolin e shkallës së tretë për çështjet administrative dhe statistikat për çështjet administrative të Gjykatës Supreme për vitin 2013 janë këto: Lëndët e pazgjdhura në fillim të periudhës raportuese ka qenë vetëm 1 lëndë, u janë shtuar edhe lëndët e reja të pranuar gjatë periudhës raportuese të cilat kanë qenë 8927 lëndë dhe numri i lëndëve të pazgjdhura ka arritur në 8921 lëndë, kurse gjatë gjithë periudhës raportuese janë zgjidhur 8921 lëndë dhe në fund të periudhës raportuese kanë mbetur vetëm 7 lëndë të pazgjdhura.⁸

Ndërsa, Gjykata e Apelit në Kosovë që nga viti 2013, do të thotë pas reformave të sistemit gjyqësor, është duke gjykuar me gjithsej 33 gjyqtarë. Lëndët e pazgjdhura në fillim të periudhës raportuese të kësaj gjykate kanë qenë 7613, u janë shtuar edhe lëndët e reja të pranuar gjatë periudhës raportuese të cilat kanë qenë 11367 lëndë dhe numri i lëndëve të pazgjdhura ka arritur në 18980 lëndë, kurse gjatë gjithë periudhës raportuese janë zgjidhur 11698 lëndë dhe në fund të periudhës raportuese kanë mbetur 7282 lëndë të pazgjdhura.

Për çështjet administrative, Gjykata e Apelit në Kosovë, ka rolin e gjykatës së shkallës së dytë dhe sa i përket lëndëve për çështjet administrative për vitin 2013 ka këto statistika: Lëndët e pazgjdhura në fillim të periudhës raportuese të kësaj gjykate kanë qenë 24, u janë shtuar edhe lëndët e reja të pranuar gjatë periudhës raportuese të cilat kanë qenë 425 lëndë, dhe numri i lëndëve të pazgjdhura ka arritur në 449 lëndë, kurse gjatë gjithë periudhës raportuese janë zgjidhur 178 lëndë dhe në fund të periudhës raportuese kanë mbetur 271 lëndë të pazgjdhura.⁹

Gjykatat Themelore të Kosovës janë duke gjykuar me gjithsej 268 gjyqtarë dhe lidhur me zgjidhjen e lëndëve ka këto statistika: Lëndët e pazgjdhura në fillim të periudhës raportuese të këtyre gjykatave kanë qenë 345676, u janë shtuar edhe lëndët e reja të pranuar gjatë periudhës raportuese të cilat kanë qenë 493992 lëndë, dhe numri i lëndëve të pazgjdhura ka arritur në 839668 lëndë, kurse gjatë gjithë periudhës raportuese janë zgjidhur 393414 lëndë, dhe në fund të periudhës raportuese kanë mbetur 446254 lëndë të pazgjdhura.

Për çështjet administrative, nga të gjitha Gjykatat Themelore, kompetente për të vendosur është vetëm Gjykata Themelore në Prishti-

⁸ Këshilli Gjyqësor i Kosovës, “Departamenti i Statistikës”, raporti vjetor 2013, f. 4

⁹ Po aty, f. 7.

në, e cila ka gjithsej 56 gjyqtarë. Kjo gjykatë, për çështjet administrative, ka këto statistika: Lëndët e pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese të kësaj gjykate kanë qenë 1947, u janë shtuar edhe lëndët e reja të pranuar gjatë periudhës raportuese të cilat kanë qenë 1720 lëndë dhe numri i lëndëve të pazgjidhura ka arritur në 3667 lëndë, kurse gjatë gjithë periudhës raportuese janë zgjidhur 1107 lëndë dhe në fund të periudhës raportuese kanë mbetur 2560 lëndë të pazgjidhura.¹⁰

Në vitin 2014, janë nxjerrë disa statistika, ku sipas atyre statistikave të gjithë gjyqtarët e emëruar në të gjitha gjykatat e Republikës së Kosovës, fatkeqësisht nuk e ushtrojnë funksionin e tyre. P.sh: Në Gjykatën Supreme janë të emëruar 14 gjyqtarë, por aktualisht funksionin e gjyqarit e ushtrojnë 13 gjyqtarë; në Gjykatën e Apelit në Prishtinë janë të emëruar 33 gjyqtarë, ndërsa aktualisht funksionin e gjyqarit e ushtrojnë 31 gjyqtarë; kurse në të gjitha Gjykatat Themelore në Kosovë janë të emëruar gjithsej 267 gjyqtarë, ndërsa aktualisht funksionin e gjyqarit e ushtrojnë 244 gjyqtarë.¹¹

Në të cekurat më lartë shihet qartë se sistemi gjyqësor i Republikës së Kosovës ka nevojë akoma më shumë për gjyqtarë, me qëllim të zgjidhjes sa më shumë të lëndëve të cilat mbesin të pazgjidhura dhe të cilat për arsye të vonesës së zgjidhjes së tyre mundën edhe të parashkruhen.

4. Siguria e gjyqtarëve dhe prokurorëve

Sipas deklarimeve të disa gjyqtarëve të Republikës së Kosovës, të cilët edhe aktualisht e ushtrojnë funksionin e gjyqarit, gjyqtarët në Republikën e Kosovës nuk kanë pasur fare siguri edhe para reformave të cilat janë bërë në sistemin gjyqësor, por gjithashtu edhe pas reformave të janarit të vitit 2013. Sipas tyre, nuk ekziston ndonjë akt juridik, me të cilin iu mundësohet siguria e gjyqtarëve në Republikën e Kosovës, përveç se në vitin 2013 është lidhur një marrëveshje e mirëkuptimit për bashkëpunim në fushën e sigurisë individuale të gjyqtarëve në rastet e kërcënimeve të tyre brenda fushëveprimtarisë gjyqësore, në mes të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Policisë së Kosovës.¹²

Kjo marrëveshje, ka për qëllim ofrimin e sigurisë individuale të gjyqtarëve, në rast të kërcënimit të tyre dhe që t'i japin njëri-tjetrit mbështetje në fushën e shkëmbimit të informatave që kanë të bëjë me

¹⁰ Po aty, f. 9-10.

¹¹ Këshilli Gjyqësor i Kosovës, "Departamenti i Statistikës", raporti vjetor 2014.

¹² Këshilli Gjyqësor i Kosovës, "Intervistë me gjyqtarët e Gjykatës Themelore në Gjilan".

rrezikun e drejtpërdrejtë me jetën dhe pronën e gjyqtarëve gjatë fushës së veprimtarisë gjyqësore.¹³

Sipas kësaj marrëveshje, obligimet e Këshillit Gjyqësor të Kosovës janë: Këshilli Gjyqësor i Kosovës do ta caktojë menaxherin e sigurisë brenda Këshillit Gjyqësor, i cili do të jetë personi përgjegjës, e që në kompetencë do të ketë pranimin e informatave për kërcënim të gjyqtarëve, analizimin e intensitetit të rrezikut, si dhe në bashkëpunim me eprorin e tij kërkon nga zyrtarët e Policisë së Kosovës sigurimin e programit të mbrojtjes për gjyqtarin e kërcënuar. Ndërsa, obligimet e Policisë së Kosovës janë: Policia e Kosovës do të caktojë zyrtarë përgjegjës, për të siguruar bashkëpunimin e ndërsjellët, me qëllim të zbatimit të kësaj marrëveshje. Policia e Kosovës, pas pranimin të kërkesës nga menaxheri i sigurimit i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, lidhur me sigurimin e programit mbrojtës për gjyqtarin e kërcënuar, duhet të veprohej konform Ligjit për Policinë dhe Udhëzimit administrativ, për mënyrën e ofrimit të ndihmës organeve qeveritare nga Policia e Kosovës. Në përputhje me ligjin dhe duke u bazuar në kërkesën e menaxherit të sigurimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, do t'i marrin masat e përshtetshme të procedurës me të cilën, pa vonesë, do të bëjnë vlerësimin e rrezikut mbi çështjen e caktuar dhe lidhur me këtë mbahet processverbal. Në rast se Policia e Kosovës vlerëson se kërkesa e menaxherit të Këshillit Gjyqësor është e bazuar, vendosin për sigurimin e programit mbrojtës për gjyqtarin e caktuar. Përgjegjës për zbatimin e programit mbrojtës është Policia e Kosovës, ndërsa menaxheri i Këshillit Gjyqësor informohet për rrjedhën e programit. Por, nëse Policia e Kosovës vlerëson se kërkesa e menaxherit të Këshillit Gjyqësor është e pabazuar, atëherë Policia e Kosovës do ta refuzojë kërkesën dhe në afat prej 3 ditëve do ta njoftojë zyrtarin e Këshillit Gjyqësor për arsyet e refuzimit.¹⁴

Ndërsa, siguria e prokurorëve në Republikën e Kosovës, është e rregulluar me Udhëzimin Administrativ për sigurinë e prokurorëve dhe personelin në prokurori.

Këshilli Prokurorial i Kosovës duhet të miratojë dhe implementojë procedurat standarde të veprimit që parashohin adresimin e mbrojtjes së afërt të prokurorëve dhe të fëmijëve të tyre në rast të kërcënimeve. Në çdo prokurori duhet të implementohet plani i sigurisë emergjente, ku për

¹³ Marrëveshje e mirëkuptimit për bashkëpunim në fushën e sigurisë individuale të gjyqtarëve në rastet e kërcënimeve të tyre brenda fushëveprimtarisë gjyqësore, e datës 28 qershor 2013, neni 2.

¹⁴ Po aty, neni 4, paragrafi 1-4.

miratimin e këtij plani është kompetente Këshilli Prokurorial i Kosovës. Planin e sigurisë emergjente duhet t'i përmbajë këto kushte:

- Procedurat emergjente që adresojnë evakuimin, emergjencat mjekësore, bombat dhe kërcënimet për bomba, situatat me pengje, arratisjet, sulmet, dëmtimet e shërbimeve komunale, katastrofat natyrore dhe përdorimi i masave paraprake të nevojshme për parandalimin e këtyre ndodhjeve;

- Diagramet e daljeve emergjente;

- Planin përgjegjës ndaj emergjencës së zhvilluar në bashkëveprim me policinë lokale dhe agjencitë tjera të shërbimeve emergjente;

- Planin e mbylljes që adreson situatat kur siguria kërkon që të gjitha dyert të mbyllen dhe i tërë stafi dhe publiku të qëndrojnë në vend;

- Procedurat e raportimit të incidenteve;

- Masat paraprake në përgjigje të korrespondencës kërcënuese ose të pavend;

- Shqetësime të tjera të identifikuara në konsultimet në mes të Kryeprokurorit të prokurorisë dhe Menaxherit të sigurisë në sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Pas miratimit, plani i Sigurimit të Prokurorisë vendoset në tabelë. Dhe pjesët e planit që përmbajnë informata të ndjeshme, mund t'i nënshtrohen shpërndarjes së kufizuar.¹⁵

Gjithashtu rol të rëndësishëm për sigurinë e prokurorëve kanë edhe rojet e sigurimit. Në pajtim me të gjitha procedurat dhe planet e veçanta të Sigurimit të Prokurorisë, rojet e sigurimit janë përgjegjës për monitorimin dhe garantimin e sigurisë në objektet e prokurorisë, gjatë dhe pas orarit të punës, duke përfshirë: kontrollimin e hyrjeve; inspektimin dhe monitorimin e vizitorëve në prokurori; patrullimin nëpër korridore, nëpër shkallë, nëpër salla të mbledhjes dhe pjesët jo publike të prokurorisë. Autorizimet e rojës së sigurimit nuk i tejkalojnë kufijtë e ndërtesës. Çdo problem që ndodh jashtë ndërtesës duhet t'i raportohet dhe të trajtohet nga ana e organeve përgjegjës për zbatimin e ligjit. Rojet e sigurimit, janë të obliguara të përdorin forcë proporcionale, nëse personi i prokurorisë është i kërcënuar apo prona është rrezikuar.¹⁶ Standardet e monitorimit të sigurimit janë: shërbimi i sigurimit ofrohet 24 orë në ditë; shpërndarja e rojeve të sigurimit në prokurori duhet të jetë proporcionale me numrin e prokurorëve dhe serioziteti i rasteve me

¹⁵ Udhëzimi Administrativ për sigurinë e prokurorëve dhe personelit në prokurori, i datës 19 qershor 2013, nr. 08/2013, neni 4, paragrafi a, b dhe c.

¹⁶ Po aty, neni 5, paragrafi a, b, c, d, e.

të cilat merren prokuroritë siç përcaktohet nga sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës; së paku një roje e sigurimit duhet të jetë i caktuar në hyrjen e prokurorisë gjatë tërë orarit të punës, hyrja asnjëherë nuk guxon të braktiset nga roja e sigurimit; rojet e sigurimit duhet t'i inspektojnë korridorët publike në pjesën e jashtme në prokurori jo më gjatë se 30 minuta natën dhe ditën; çdo hyrje e prokurorisë duhet të pajiset me nga një detektor, për kontrollimin e të gjithë personave që hyjnë në prokurori; standardet tjera të monitorimit të sigurimit mund të miratohen, ndryshohen dhe implementohen siç përcaktohet nga sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës.¹⁷

5. Transferimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve

Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri për gjykatat, përkatësisht me reformimin e sistemit gjyqësor, është bërë i domosdoshëm edhe ricaktimi dhe transferimi i gjyqtarëve nëpër gjykatat themelore dhe gjykatës së apelit. Por, gjatë procesit të ricaktimit dhe transferimit të një gjyqtari në strukturën e re të gjykatave, gjyqtari nuk do të transferohet jashtë rajonit gjeografik ku ai gjyqtar ka qenë i caktuar para 1 janarit 2013, përveç kur kjo është e nevojshme me qëllim të funksionimit më efikas të gjyqësorit.¹⁸

Me miratimin e kryetarëve përkatës të Gjykatave, Këshilli mund të transferojë një gjyqtar në një gjykatë tjetër për një periudhë kohore, por jo më gjatë se gjashtë (6) muaj për një herë të vetme. Transferimi mund të kryhet në rastet kur gjykata tjetër ka numër të pamjaftueshëm të gjyqtarëve për dëgjimin e një lënde të caktuar nën kompetencën e saj. Kryesuesi i Këshillit, në rrethana të jashtëzakonshme, mund të transferojë përkohësisht një gjyqtar në një gjykatë apo degë tjetër të gjykatës. Cilido transfer brenda kësaj dispozite nuk do të tejkalojë tridhjetë (30) ditë përveç nëse një kohë më e gjatë miratohet nga Këshilli. Gjyqtarët, në asnjë rast, nuk mund të transferohen në cilëndo gjykatë tjetër kundër vullnetit të tyre, përveç kur është e nevojshme të sigurohet funksionimi më efikas i gjykatave apo për të adresuar rrethana të jashtëzakonshme. Gjyqtarët mund të aplikojnë pranë Këshillit për transferim të përherëshëm në një gjykatë tjetër.

Gjyqtarët kanë të drejtë në ankesë, drejtpërsëdrejti në Gjykatën Supreme, kundër një vendimi të Këshillit për zhvendosje të përherëshme

¹⁷ Po aty, neni 8, paragrafi a, b, d, e, f, g dhe j.

¹⁸ Rregullore për ricaktimin dhe transferimin e gjyqtarëve në Gjykatat Themelore dhe në degët e Gjykatave Themelore, e datës 7 shtator 2012, neni 2. paragrafi 4.

apo transfer që tejkalon periudhën gjashtë (6) mujore. Këshilli shpallë rregullat dhe rregulloret që themelojnë standardet dhe procedurat që qeverisnin ankesat. Kur kryhet një transferim i përhershëm apo që tejkalon periudhën gjashtë (6) mujore, Këshilli do të përpiqet të sigurohet se zhvendosja apo transferimi nuk do të ndryshojë përbërjen etnike të gjykatës e cila preket nga zhvendosja apo transferi.¹⁹

Për transferimin e një gjyqtari në Departamentin për Krime të Rënda të Gjykatës Themelore, gjyqtari duhet të ketë së paku tre (3) vjet përvojë si gjyqtar në çështje penale dhe së paku gjashtë (6) vjet përvojë në fushën e drejtësisë, përfshirë edhe përvojën në fushën e të drejtës penale. Gjyqtarët penal me përvojë, që janë të caktuar në Gjykatat e Qarkut dhe në Gjykatat Komunale në rajonin ku ka vende të lira në departamentin për krime të rënda, kanë pasur përparësi në procesin e ricaktimit dhe transferimit të gjyqtarëve në departamentin e krimeve të rënda.²⁰ Ndërsa, për Departamentin për Çështje Administrative në Gjykatën Themelore përfshirë edhe divizionin fiskal, gjyqtari është dashur të ketë së paku gjashtë vjet (6) vjet përvojë në fushën e drejtësisë, përfshirë edhe përvojën në çështjet e të drejtës administrative, respektivisht në çështjet e të drejtës fiskale për divizionin fiskal.²¹ Për Departamentin e Përgjithshëm të Gjykatave Themelore janë ricaktuar të gjithë gjyqtarët e Gjykatave Komunale të Kundërvajtjes në Divizionin për Kundërvajtje. Gjyqtarët nga fusha civile dhe penale të strukturës së kaluar të gjykatave të cilët nuk janë ricaktuar në Departamentet e specializuara, janë ricaktuar në Departamentin e Përgjithshëm të Gjykatave Themelore dhe degëve të saj.²²

Për të shërbyer në Departamentin Ekonomik të Gjykatës Themelore, gjyqtari aktual duhet të ketë së paku gjashtë (6) vjet përvojë pune në fushën e drejtësisë, përfshirë edhe përvojën në çështjet e të drejtës ekonomike. Përzgjedhja e gjyqtarëve për departamentin ekonomik të Gjykatës Themelore do të bëhet nga radhët e gjyqtarëve ekonomik aktual të Gjykatës Ekonomike të Prishtinës, përveç në rastet e përcaktuara me nenin 2.4 të kësaj Rregulloreje.²³

¹⁹ Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nr. 03/L-223, neni 20, paragrafi 1-7.

²⁰ Rregullore për ricaktimin dhe transferimin e gjyqtarëve në Gjykatat Themelore dhe në degët e Gjykatave Themelore, e datës 7 shtator 2012, neni 3, paragrafi 1-3.

²¹ Po aty, neni 4.

²² Po aty, neni 5, paragrafi 1-2.

²³ Rregullore për ricaktimin dhe transferimin e gjyqtarëve në Gjykatat Themelore dhe në degët e Gjykatave Themelore, e datës 7 shtator 2012, neni 5. Paragrafi 1-2.

Në reformën e sistemit gjyqësor në Kosovë ka qenë sfidë transferi i gjyqtarëve nga një gjykatë në gjykatën tjetër. Kjo është bërë për shkak se kanë ekzistuar mungesat e kadrove profesionale, për departamentet e specializuara, sidomos në atë të krimeve të rënda. Themelimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë dhe Gjykatës Themelore në Ferizaj, për Këshillin Gjyqësor ka qenë sfidë e madhe, pasi që për herë të parë janë themeluar këto gjykata dhe nuk ka pasur mundësi të sistemohen gjyqtarë adekuat të cilët i plotësojnë kushtet për të ushtruar funksionin e tyre në këto dy Gjykata Themelore, përkatësisht në Departamentet për Krime të Rënda, nga se një pjesë e gjyqtarëve kanë qenë gjyqtarë të rinj dhe nuk kanë kaluar as procesin e riemërimit të mandatit të tyre, ku ky proces është kusht për të ushtruar funksionin e gjyqtarit në Departamentin për Krime të Rënda. Dhe për këtë arsye është dashur të bëhet transferimi i gjyqtarëve nga një gjykatë në gjykatën tjetër. Ndërsa, sa i përket në Gjykatën e Apelit, për Këshillin Gjyqësor nuk ka qenë ndonjë vështirësi e madhe pasi që ka shpallur konkurs dhe me interesimin e kandidatëve është bërë edhe sistemimi i gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit.²⁴

Edhe transferimi i prokurorëve ngjanë shumë me transferimin e gjyqtarëve, do të thotë: me paraqitjen e kërkesës nga Kryeprokurori, Këshilli mund të transferojë një prokuror në një prokurori tjetër për një periudhë kohore jo më të gjatë se gjashtë (6) muaj për një herë. Transferimi mund të ndërmerret në rastet kur një prokurori ka numër të pamjaftueshëm të prokurorëve për të kryer lëndët që i ka në kompetencë. Për raste të jashtëzakonshme, Kryeprokurori i Shtetit mundet përkohësisht, të transferojë një prokurorë në një prokurori tjetër. Transferimi i ndërmarrë sipas kësaj dispozite nuk mund të tejkalojë tridhjetë (30) ditë, përveç nëse Këshilli miraton një periudhë më të gjatë. Prokurorët nuk mund të transferohen në ndonjë prokurori tjetër, kundër vullnetit të tyre, përveç nëse ky ligj e përcakton ndryshe. Me rastin e aplikimit pranë Këshillit, një prokurorë mund të transferohet në një prokurori tjetër në mënyrë permanente. Këshilli shpallë rregullat dhe rregulloret që përcaktojnë standardet dhe procedurat që qeverisin ankesat. Kur kryhet një zhvendosjeje apo transferim i përhershëm, që tejkalon gjashtë (6) muaj, Këshilli përpiket të sigurohet se zhvendosja apo transferimi nuk do të ndryshojë përbërjen etnike të prokurorisë e cila ndikohet nga zhvendosja apo transferimi.²⁵

²⁴ Këshilli Gjyqësor i Kosovës, "Intervistë me z. Enver Peci - kryesues i KGJK-së".

²⁵ Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nr. 03/L-224, neni 22, paragrafi 1-7.

Për tu caktuar apo transferuar një prokurorë në Departamentin e Krimeve të Rënda të Prokurorive Themelore, prokurori është dashur t'i ketë ushtruar së paku tre vjet detyrat e prokurorit apo gjyqtarit. Ndërsa, për Prokurorinë e Apelit, prokurori është dashur t'i ketë ushtruar së paku 4 vjet detyrat e prokurorit apo gjyqtarit.²⁶ Prokurorët të cilët kanë qenë prokurorë komunal janë sistemuar në kuadër të Departamentit të Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore. Ndërsa, prokurorët të cilët kanë qenë prokurorë të qarkut janë sistemuar në Departamentet e Specializuara të Prokurorive Themelore.²⁷

Sa i përket transferimit të prokurorëve, Këshilli Prokurorial nuk ka pasur vështirësi në reformën e sistemit prokurorial, ngase Këshilli Prokurorial ka nxjerrë një rregullore për caktimin dhe transferimin e prokurorëve në pozitat e reja, ku në bazë të asaj rregullore prokurorët të cilët kanë punuar në prokuroritë komunale parimisht janë përcaktuar në Departamentin e Përgjithshëm të Prokurorive Themelore, ndërsa prokurorët që kanë punuar në prokuroritë e qarkut janë përcaktuar në Departamentin për Krime të Rënda dhe në Departamentin për të Mitur. Gjithashtu, është bërë një shpallje publike për kalimin e prokurorëve në departamente të caktuara, ku komisioni i caktuar nga Këshilli Prokurorial, në bazë të kriterëve të caktuara në rregullore, ka vlerësuar rastet veç e veç dhe ka përfunduar transferimin e prokurorëve në departamentet e caktuara.²⁸

6. Vendet e rezervuara për komunitetet jo shumicë në sistemin gjyqësor dhe sistemin prokurorial në Kosovë

Sistemimi për vendet e rezervuara për komunitetet jo shumicë në Kosovë, në reformat e sistemit gjyqësor dhe sistemit prokurorial kanë paraqitur vështirësi të madhe, ngase me ligjin e ri për gjykatat janë të rezervuara shumë vende për komunitetin jo shumicë në Kosovë, ndërsa në praktikë realizimi i tyre është i pamundur. Çka do të thotë se, me ligjin e ri për gjykatat, janë paraparë 33 vende të rezervuara për komunitetet jo shumicë në Kosovë, ku vetëm në Gjykatën e Apelit kanë qenë të rezervuara 15% të vendeve ose së paku 10 gjyqtarë nga radha e komuniteteve. Pasi që kanë qenë vende të rezervuara atëherë nuk ka

²⁶ Rregullore për caktimin dhe transferimin e prokurorëve, nr. 03/2012, paragrafi 2.1 dhe 2.2.

²⁷ Po aty, neni 5, paragrafi 4-5.

²⁸ Këshilli Prokurorial i Kosovës, "Intervistë me z. Shkëlzen Maliqi - drejtor i përgjithshëm i KPK-së".

pasur mundësi të mbushen nga shqiptarët dhe kjo ka ndikuar shumë në çështjen e vonesës së zgjidhjes së lëndëve.²⁹ Gjithashtu, vendet e rezervuara për komunitetet jo shumicë në Kosovë, kanë paraqitur vështirësi edhe në sistemin prokurorial, ku ka qenë sfidë e madhe kompletimi i stafit prokurorial, si dhe rekrutimi i komuniteteve jo shumicë në Kosovë në pozitë të prokurorëve.³⁰

Reformimi i sistemit gjyqësor ka qenë i domosdoshëm për integritet në Bashkimin Evropian. Kërkesa për reformat në sistemin gjyqësor të Republikës së Kosovës kanë qenë nga vet shoqëria Kosovare, por po ashtu edhe nga institucionet ndërkombëtare. Për këto reforma është dashur të jepet një përkushtim i madh nga institucionet e Kosovës, pasi që pa reformimin e sistemit gjyqësor në Kosovë, nuk do të kishte reformim të mirëfilltë as në ekonominë e as në politikën e vendit.³¹

Conclusion

The challenges during reforms within the justice system in the Republic of Kosovo that were: lack of facilities; the insufficient number of judges and the more active cases of active judges; security of judges and prosecutors; the transfer of judges and prosecutors as well as the seats reserved for the non-majority community in the judicial and prosecutorial system of the Republic of Kosovo have presented great difficulties for the implementation of reforms in the justice system of the Republic of Kosovo. Therefore, justice system institutions in Kosovo must make room for the purpose of functionalizing and implementing reforms of this system in the best possible way.

The inadequate number of judges, apparently, have been inherited from the justice system of the past in today's justice system. Even after the reforms in the justice system in the Republic of Kosovo, there are still many unresolved cases and because of the non-resolution of those cases, those subjects may be statute-barred or obsolete without being solved at all. Therefore, in the Republic of Kosovo should be appointed judges and if their appointment is not possible for a long time, then a project should be made under which temporary judges should be appointed, until the resolution of those cases remained unresolved.

²⁹ Këshilli Gjyqësor i Kosovës, “Intervistë me z. Enver Peci - kryesues i KGJK-së”.

³⁰ Këshilli Prokurorial i Kosovës, “Intervistë me z. Shkëlzen Maliqi - drejtor i përgjithshëm i KPK-së”.

³¹ Flamur Hyseni – Burim Haliti, “Opinione I”, Gjilan 2012, f. 81-82.

Security of judges and prosecutors in the Republic of Kosovo is not at the right level. Therefore, as the function of a judge and a prosecutor is sensitive and dangerous, the Kosovo Judicial and Prosecutorial Council of the Republic of Kosovo should attach great importance to the security of judges and prosecutors by creating different mechanisms to providing protection in case of threats, both during working hours and outside working hours if they need it.

By concluding this scientific paper, in the hope to take action by the competent people to avoid the above-mentioned challenges in order to make the best possible functioning of the justice system in the Republic of Kosovo.

Bibliography

- Hyseni, Flamur - Haliti, Burim: “Opinione I”, Gjilan 2012.
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës, “Intervistë me z. Enver Peci - kryesues i KGJK-së”.
- Këshilli Prokurorial i Kosovës, “Intervistë me z. Shkelzen Maliqi - drejtor i përgjithshëm i KPK-së
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës, “Intervistë me gjyqtarët e Gjykatës Themelore në Gjilan”.
- Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nr. 03/L-223.
- Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nr. 03/L-224.
- Rregullore për caktimin dhe transferimin e prokurorëve, nr. 03/2012.
- Rregullore për ricaktimin dhe transferimin e gjyqtarëve në Gjykatat Themelore dhe në degët e Gjykatave Themelore, e datës 7 shtator 2012.
- Udhëzimi Administrativ për sigurinë e prokurorëve dhe personelit në prokurori, i datës 19 qeshor 2013, nr. 08/2013.
- Marrëveshje e mirëkuptimit për bashkëpunim në fushën e sigurisë individuale të gjyqtarëve në rastet e kërcënimeve të tyre brenda fushëveprimtarisë gjyqësore, e datës 28 qershor 2013.
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës, “Departamenti i Statistikës”, raporti vjetor 2012.
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës, “Departamenti i Statistikës”, raporti vjetor 2013.
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës, “Departamenti i Statistikës”, raporti vjetor 2014.